

I ftohtë akull - një temperaturë e jashtëzakonshme minus tetëmbëdhjetë gradë, për më tepër po bie dëborë, dhe në atë gjuhë që s'është më e imja, dëborës i thonë *qanik* - kristale të mëdhenj pothuajse të papeshë bien në tufa duke mbuluar dheun me një shtresë ngrice të bardhë si pluhur. Errësira e dhjetorit ngrihet nga varri, duke u shfaqur po aq e pakufishme sa dhe qielli mbi ne. Në këtë errësi, fytyrat tona janë thjesht disqe me dritë të zbehtë, por megjithatë unë arrij ta ndjej mosmiratimin e pastorit dhe sakristanit për getat e zeza rrjetë që kam veshur dhe për rënkimet e Julianës, të përkeqësuar nga fakti që sot në mëngjes ka pirë disulfid dhe tani po përballet me dhimbjen pothuajse esëll. Ata mendojnë se ajo dhe unë s'kemi respekt as për motin dhe as për rrethanat tragjike. Por e vërteta është se si getat, ashtu edhe ilaçet janë në atë mënyrën e vet, një homazh ndaj të ftohtit dhe Isajas.

Gratë që rrethojnë Julianën, pastori dhe sakristani janë të gjithë groenlandezë dhe kur ne këndojmë "Guutiga, illimi", "O Zoti ynë," dhe Julianën nuk e mbajnë më këmbët e ia nis të qarës që dalëngadalë shtohet, dhe kur pastori nis të flasë në groenlandishten perëndimore, duke e marrë shtysën nga pjesa e parapëlqyer e moravianëve, nga Shën Pavli, për shlyerjen e fajit përmes gjakut të Tij, atëherë mjafton vetëm një shpërqendrim i vogël që të të duket sikur je në Upernavik, Holsteinsborg apo Qaanaaq, në Groenlandë.

Por atje jashtë në errësi, si bashi i një anijeje, shquhen muret e burgut Vestre, ndodhemi në Kopenhagen.

Varrezat e groenlandezëve janë pjesë e varrezave të Vestres. Një kortezh i përbërë nga miqtë e Julianës, që po e mbajnë atë në këmbë, pastori dhe sakristani, mekaniku dhe një grup i vogël danezësh, mes të cilëve njoh vetëm oficerin e lirimit me kusht dhe inspektorin, ndjek Isajan në arkivolin e tij.

Ato që po thotë pastori më bën të mendoj se duhet ta ketë njohur vërtet Isajan, megjithëse, me aq sa di unë, Juliana s'ka shkuar kurrë në kishë.

Pastaj, zëri i tij zhduket sepse tani dhe gratë e tjera po dënesin bashkë me Julianën.

Shumë kanë ardhur, ndoshta njëzetë e, tashmë ata e lënë dhimbjen e tyre t'i lajë në lot si një lum i zi, në të cilin zhyten duke e lënë veten t'i rrëmbejë në një mënyrë që asnjë i jashtëm s'do mund ta kuptonte: askush që nuk është rritur në Groenlandë. Madje edhe kjo mund të mos jetë e mjaftueshme. Sepse as unë nuk i ndjek dot.

Për herë të parë, vështroj nga afër arkivolin. Është gjashtëkëndor. Në një çast kristalet e akullit marrin të njëjtën formë.

Tani po e fusin në dhe'. Arkivoli është prej druri të errët, duket aq i vogël dhe që tani është mbuluar me një shtresë dëbore. Flokët janë si pupla të vogla, dhe dëbora kështu është, jo domosdoshmërisht e ftohtë. Ajo që po ndodh në këtë çast është se qielli po qan për Isajan, dhe lotët po shndërrohen në

pupla të akullta që po e mbulojnë. Në këtë mënyrë, universi po i hedh sipër një jorgan me pupla, që ai të mos ketë më kurrë ftohtë.

Në çastin kur pastori hedh dhé mbi arkivol dhe ne duhet të largohemi, bie një heshtje e cila duket e gjatë. Gratë janë të heshtura, askush nuk lëviz, është një lloj heshtjeje që sikur pret që diçka të shpërthejë. Ashtu siç e shoh unë, dy gjëra ndodhin.

E para, Juliana bie në gjunjë, mbështet fytyrën përdhé dhe gratë e lënë vetëm.

Ngjarja e dytë është diçka që ndodh brenda meje, ku shpërthimi është një intuitë.

Mes nesh duhet të ketë patur gjatë gjithë kohës një marrëveshje që të mos e lija në baltë, kurrën e kurrës, as tani.

2

Ne banojmë në Qelat e Bardha.

Në një shesh ndërtimi të dhuruar, Shoqata e Strehimit ka ngritur një radhë kutish parafabrikate çimentoje të bardhë, për të cilat ka marrë dhe një çmim nga Shoqata për Zbukurimin e Kryeqytetit.

E gjitha, përfshi këtu edhe çmimin, të jep përshtypjen e diçkaje të lirë dhe të pamjaftueshme, por s'ka asgjë të rëndomtë kur vjen fjala te qiraja, e cila është aq e lartë saqë të vetmit që mund ta përballojnë jetesën këtu janë njerëz si Juliana, të cilën e mban shteti, mekaniku, të cilit iu desh të merrte çfarëdo që të gjente, dhe ata që jetojnë sot për nesër, si puna ime.

Kështu që nofka, Qelat e Bardha, është fyese për të gjithë ne që banojmë këtu, por megjithatë, në një farë mënyre, është mjaft e gjetur.

Ka arsye përse dikush shkon të banojë diku e arsye përse qëndron. Me kohë, uji është bërë i rëndësishëm për mua. Qelat e Bardha ndodhen pikërisht mbi Portin e Kopenhagenit. Këtë dimër, pata mundësi të shikoj formimin e akullit.

Ngrica erdhi në nëntor. Unë kam respekt për dimrin danez. I ftohti - jo ai që matet me termometër, por ai që e ndien ti vetë - varet më shumë nga forca e erës dhe nga lagështia relative në ajër sesa nga vetë temperatura. Në Danimarkë e kam ndjerë më shumë të ftohtin nga ç'e kam ndjerë ndonjëherë kur isha në Thule, në Groenlandë. Kur shirat e parë të ftohtë të nëntorit nisën të më fshikullonin fytyrën si me një peshqir të lagur, unë i prita me një palë *capucines* me konture gëzofi, geta të zeza alpake, një fund të gjatë skocez, një pulovër dhe një pelerinë të zezë Gore-Tex. Pastaj temperatura nis të bjerë. Në një pikë, sipërfaqja e detit arrin minus 1.8 gradë Celsius dhe formohen kristalet e para, një membranë e përkohshme të cilën era dhe dallgët e thyejnë duke e kthyer në akull frazil, që pastaj shndërrohet në një si qull të rrëshqitshëm të quajtur grease ice, që

gradualisht krijon pllakëza që pluskojnë lirisht, akull në formë piteje, i cili një ditë të diel të ftohtë, në mesëditë, ngrin duke u shndërruar në një shtresë të vetme kompakte.

Moti ftohet edhe më dhe unë jam e lumtur sepse e di që tani ngrica ka fituar terren, tani akulli do të qëndrojë, tani kristalet kanë formuar ura dhe e kanë mbyllur ujin e kripur në xhepa me një strukturë që i ngjan rrembave të një peme përmes të cilave lëngu kullon ngadalë. Jo shumë nga ata që e hedhin vështrimin nga Holmeni e mendojnë këtë, por është një arsye për të besuar që akulli dhe jeta janë të lidhura bashkë në shumë mënyra.

Akulli është ai që zakonisht kërkoj të parin kur ngjitem në urën Knipels. Por, në këtë ditë dhjetori, shoh diçka tjetër. Shoh një dritë.

Është e verdhë, ashtu siç janë shumica e dritave në një qytet gjatë dimrit, dhe ka rënë dëborë, kështu që ndonëse s'është veçse një dritë e zbehtë, ka një reflektim të fortë.

Ajo ndriçon rrëzë njëërës prej depove, që në një çast dobësie vendosën të mos e prishnin, kur ndërtuan bllokun e pallateve tona. Në fund të ballinës së ndërtesës, në drejtim të rrugës Strand dhe Kristianshavn, vërtitet drita blu e një makine patrullimi. Arrij të dalloj një oficer policie si dhe rrethimin e përkohshëm me shirit të kuq e të bardhë. Arrij të shquaj përballë ndërtesës dhe atë që është pas rrethimit: një hije të vogël të errët në dëborë.

Meqë po vrapoj dhe meqë sapo ka shkuar ora pesë dhe trafiku i mbrëmjes ende s'është rralluar, mbërrij aty disa minuta përpara ambulancës.

Isaja dergjet me këmbët e mbledhura nën vete, fytyrën në dëborë dhe duart rreth kokës, si për t'u mbrojtur nga drita e projektorit të vogël që e ndriçonte, sikur dëborë të ishte një xham përmes të cilit arrinte të shihte diçka në thellësi të tokës.

Sigurisht që oficeri i policisë duhet të më pyesë se kush jam, të mbajë shënim emrin dhe adresën time, duke përgatitur kështu gjërat për kolegët e tij që së shpejti do t'u duhet të nisin të trokasin nëpër dyer. Por ai është i ri në moshë, me një shprehje të sëmurë në fytyrë. Përpiqet të mos i hedhë sytë nga Isaja. Pasi u sigurova që s'kisha ndërmend ta kaloja shiritin e tij, më la të rrija aty. Mund të kishte rrethuar një zonë më të gjerë ndonëse jo se do të ndryshonte ndonjë gjë. Depot janë duke u rinovuar pjesërisht. Njerëzit dhe makineritë e kanë ngjeshur dëborën aq fort, saqë e kanë bërë atë të fortë si dyshemeja e një tarrace.

Edhe i vdekur, te Isaja ka diçka të ndrojtur, sikur të kërkojë që askush të mos ndjejë keqardhje për të.

Lart, mbi kokat tona, jashtë rrezes së projektorit, mezi shquhet një çati. Depoja është e lartë, ndoshta po aq sa një pallat shtatë apo tetë katësh. Ndërtesa ngjitur po rinovohet. Në ana që sheh nga Strandvej, kanë ngritur skela. Unë drejtohem për atje, ndërkohë që ambulanca kaloi mbi urë dhe pastaj nisi të lëvizë përmes ndërtesave.

Skela mbulon fasadën deri lart në çati. Shkalla e fundit është e ulur. Sa më lart që ngjitem, aq më e paqëndrueshme bëhet struktura.

Po ndërtojnë një çati të re. Sipër meje duken qartë kapriatat trekëndore të mbuluara me mushama. Ato zgjaten përgjatë gjysmës së gjatësisë së ndërtesës. Gjysma tjetër e çatisë, ajo që sheh nga porti, tani është një sipërfaqe e mbuluar nga dëborë. Aty janë dhe gjurmët e Isajas.

Buzë dëborës, një burrë është mbledhur kruspull me krahët rreth gjunjëve duke u tundur sa para mbrapa.

Edhe ashtu i kërrusur, mekaniku të jep përshtypjen se është trupmadh. Dhe në këtë pozicion dorëzimi të plotë, ai prapë duket se është njeri i rezervuar.

Drita është aq e fortë. Disa vite më parë, matën ndriçimin në Siorapaluk, në Groenlandë. Nga dhjetori në shkurt, tre muajt kur nuk ka diell. Njerëzit përfytyrojnë një natë të përjetshme. Por janë yjet dhe hëna, dhe herë pas here, agimi polar. Dhe dëbora. U regjistrua i njëjti ndriçim me atë të periferisë së një qyteti të mesëm provincial në Danimarkë. Ja se si e kujtoj fëmijërinë time. Luanim gjithmonë jashtë dhe se kishte gjithmonë dritë. Atë kohë, ne e merrnim dritën për të mirëqenë. Për një fëmijë shumë gjëra janë të mirëqena. Pastaj, me kalimin e kohës fillon të bësh pyetje.

Por sidoqoftë, më bën përshtypje sa e ndriçuar është çatia që kam përpara. Dukej sikur të qe dëbora, një shtresë ndoshta nja tetë centimetra e trashë, që kish krijuar dritën në këtë ditë dimri dhe që vazhdonte të ndriçonte me një shkëlqim të herëpashershëm si prej perlash të vogla rrëzëllitëse ngjyrë gri.

Në tokë dëbora shkrin gjithnjë nga pak, madje dhe atëherë kur bën ngricë e madhe, për shkak të nxehtësisë së qytetit. Por këtu lart ajo dergjet e qetë, ashtu siç ka rënë. Vetëm Isaja e ka shkelur.

Edhe kur nuk ka nxehtësi, kur s'bie dëborë e re, s'fryn erë, edhe atëherë dëbora ndryshon. Sikur të marrë frymë, sikur të dendësohet të ngrihet e ulet, e pastaj të shpërbëhet.

Mbante veshur atlete, edhe në dimër, dhe ato janë gjurmët e tij, shualli i ngrënë i këpucëve të basketbollit me një kontur rrathësh koncentrikë që mezi duken përballë harkut ku një lojtar duhet të rrotullohet.

Ka filluar të ecë në dëborë që këtu ku jemi ne. Gjurmët e këmbëve shkojnë në mënyrë diagonale drejt e buzë çatisë dhe pastaj vrapojnë përgjatë saj për ndoshta dhjetë metra. Atje ndalojnë. Pastaj, vazhdojnë drejt qoshes në fund të ndërtesës, ku ndjekin buzën e çatisë në një largësi prej rreth gjysmë metri, deri tek qoshja përballë depos tjetër. Që aty, ai është kthyer rreth tre metra për nga brenda, që të merrte vrull. Më pas, gjurmët shkojnë drejt për tek skaji i çatisë prej nga u hodh.

Çatia tjetër ka tjegulla të zeza të veshura me akull, të cilat formojnë një kënd aq të pjerrët me ullukun, saqë dëbora ka rrëshqitur. S'ka asgjë ku mund të mbahesh. Qe njësoj sikur të kishte kërcyer drejt e në boshllëk.

Nuk ka gjurmë të tjera këmbësh përveç atyre të Isajas. Në sipërfaqen e dëborës s'ka qenë askush tjetër përveç tij.

- Unë e gjeta, - thotë mekaniku.

S'e kam kurrë të lehtë të shoh burrat të qajnë. Ndoshta sepse e di sa fatale është e qara për respektin që kanë ndaj vetes. Ndoshta sepse për ta është aq e pazakontë, saqë i kthen gjithmonë në fëmijëri.

Mekaniku ka arritur në atë pikë ku ka hequr dorë nga fshirja e syve, fytyra e tij është një maskë e përlotur.

- Po vijnë të panjohur, - them unë.

Dy burrat që vijnë mbi çati s'janë dhe aq të kënaqur që na shohin.

Një prej tyre ka me vete pajisje fotografike dhe po i merret fryma. Tjetri më kujton paksa një thua këmbe që rritet nga brenda. I sheshtë, i sertë, gjithë irritim e padurim.

- Po ju kush jeni?

- Fqinja e katit sipër, - them unë. - Kurse ky zotëria banon një kat më poshtë.

- Ka mundësi të largoheni?

Më pas, ai vë re gjurmët dhe na harron.

Fotografi bën fotografitë e para me blitz, me një kamera të madhe Polaroid.

- Vetëm gjurmët e të ndjerit - thotë Thoi i Këmbës. Ai flet sikur të ishte duke e shkruar raportin në mendjen e tij. "Nëna është e alkoolizuar. Kështu që ka ardhur të luajë këtu lart."

Na vë re përsëri.

- Ata duhet të zbresin.

Atë çast, unë s'jam e qartë për asgjë, jam vetëm konfuze. Por kam aq shumë turbullirë brenda vetes, saqë mund t'iu fal ca edhe të tjerëve. Kështu që nuk luaj vendit.

- Mënyrë e çuditshme për të luajtur, si thoni? - e pyes.

Dikush mund të thotë se unë jam mendjemadhe. Dhe jo domosdoshmërisht do ta kundërshtoja.

Mund të kem arsyet e mia për këtë. Sido që të jetë, është veshja ime ajo që e bën të më dëgjojë.

Pulovra prej kashmiri, kapela prej peliçeje, dorashkat. Duket qartë se do që të më zbresë poshtë.

Por e shikon që kam pamjen e një zonje elegante. Dhe nuk takon shumë zonja elegante në çatitë e Kopenhagenit.

Kështu që ngurron për një çast.

- Ç' doni të thoni?

- Kur ishit në moshën e tij, - them unë - dhe babai me nënën tuaj ende s'ishin kthyer në shtëpi nga minierat e kripës, dhe ti luaje vetëm në çatinë e barakave të të pastrehëve, a ju ka ndodhur të vraponi drejt e në buzë të çatisë?"

Ngurron për një çast.

- Jam rritur në Jutland - thotë pastaj. Por nuk m'i shqit sytë ndërkohë që flet.

Më pas kthehet nga kolegu.

- Të sjellim pak ndriçim këtu. Dhe shoqëroi zonjën me zotërinë poshtë...